# V E N D I M
**Nr.353, datë 28.3.1991**

## PËR DISA NDRYSHIME E SHTESA NË VENIDIMIN E PRESIDIUMIT TË KUVENDIT POPULLOR NR.255, DATË 30.6.1980 "MBI CAKTIMIN E DETYRAVE (KOMPETENCAVE) TË KËSHILLIT POPULLOR TË FSHATRAVE, TË FSHATRAVE TË BASHKUARA, TË LAGJEVE TË QYTETEVE DHE TË RAJONEVE TË QYTETIT TË TIRANËS E TË KAVAJËS

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshillit të Ministrave;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në vendimin e Presidiumit të Kuvendit Popullor nr.255, datë 30.6.1980, bëhen këto ndryshime e shtesa:

Në titullin e vendimit dhe të pikës 1 të tij, pas fjalëve "….të qytetit të Kavajës" shtohen fjalët "…dhe të qytetit të Patosit"

Në titullin "Detyrat e këshillit popullor të rajonit të Tiranës e të qytetit të Kavajës" shtohen fjalët "…dhe të qytetit të Patosit".

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
**Sihat Tozaj**

KRYETARI
**Ramiz Alia**